Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Raport i Vlerësimit *Ex-Post* për Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës[1]

[1] Raport i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, është miratuar në mbledhjen e 08-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 06/08, të datës 28.10.2026.

Raport i Vlerësimit *Ex-Post* për Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës

Institucioni propozues	Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit – Qeveria e Republikës së Kosovës
Titulli i Raportit të Vlerësimit *Ex-Post*	Raport i Vlerësimit *Ex-Post* për Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës
Personi kontaktues	Mentor Borovci – Drejtor i Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit – Qeveria e Republikës së Kosovës
Grupi punues	1.Grupi Punues për hartimin e Raportit të Vlerësimit *Ex-Post* në këtë përbërje: 1.1. Mentor Borovci, ZL/ZKM, Kryesues; 1.2. Habit Hajredini, ZL/ZKM, Zv.kryesues; 1.3. Naser Canolli, ZPGZ/ZKM, Anëtar; 1.4. Feride Podvorica, DL/MD, Anëtare; 1.5. Naim Shala, DL/MPB, Anëtar; 1.6. Alberita Hyseni, ZL/ZKM, Anëtare; 1.7. Ervina Gashi, ZL/ZKM, Anëtare; 1.8. Qëndresa Ibra Zariqi, ZQM/ZKM, Anëtare; 1.9. Merita Jonuzi, MASHTI, Anëtare; 1.10. Merita Vuthaj, MSH, Anëtare; 1.11. Adile Shaqiri, MD, Anëtare; 1.12. Luljeta Ibishi-Ferizi, MAPL, Anëtare; 1.13. Nilgyn Kosova, PK, Anëtare; 1.14. Liridona Hoti, ZL/ZKM, Anëtare; 1.15. Azem Reqica, MFPT, Anëtar; 1.16. Magbule Koci, MD, Anëtare; 1.17. Fitore Rexhaj, MD, Anëtare; 1.18. Fadil Abdyli, PK, Anëtar. 2.Nga Shoqëria Civile, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e pavarura: 2.1. Pajtim Zeqiri, TDH; 2.2. Dren Rexha, UNICEF; 2.3. Dritan Bernjashi, KGJK, Anëtar; 2.4. Baki Gimolli, Institucioni i Avokatit të Popullit.
Data	**23.10.2026**

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës vendos bazën normative për mbrojtjen e të drejtave themelore të fëmijës, duke e përcaktuar se: Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. [2] Kjo bazë garanton që mbrojtja institucionale dhe ligjore e fëmijëve të jetë e integruar brenda sistemit kushtetues dhe në përputhje me parimet ndërkombëtare.

2. Dispozitat e Kushtetutës që i kushtohen posaçërisht të drejtave të fëmijës gjenden në nenin 50[3], i cili përfshin të drejtën për mbrojtje dhe kujdes të domosdoshëm, mbrojtje nga dhuna dhe eksploatimi, të drejtën për kontakte me prindërit, si dhe parimin e interesit më të mirë të fëmijës si standard themelor kushtetues.

3. Kushtetuta gjithashtu njeh aplikimin e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokolleve të saj, të cilat kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike në rast mospërputhjeje.[4] Kjo garanton që të drejtat e fëmijëve të jenë të mbrojtura në përputhje me standardet më të avancuara evropiane dhe ndërkombëtare.

4. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 Nëntor 1989, dhe që ka hyrë në fuqi më 2 shtator 1990[5] përfaqëson një traktat gjithëpërfshirës që i garanton fëmijës një gamë të gjerë të drejtash. Me nenin 22 të Kushtetutës, është përcaktuar edhe zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës në Kosovë[6] e cila përbën një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve. Konventa është pjesë përbërëse e rendit juridik të Kosovës dhe, si e tillë, gëzon përparësi normative ndaj legjislacionit vendor në rast mospërputhjeje. Kjo do të thotë se çdo gjykatë, autoritet administrativ apo institucion publik në Kosovë është

[2] *Shih* nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e qasur https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702 më 31.03.2025
[3] *Ibid*., neni 50.
[4] *Ibid*., neni 22. [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], parag. 2
[5] *Shih* Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e qasur në https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73755 më 01.04.2025.
[6] *Ibid*., neni 22 parag. 7.

i detyruar të zbatojë drejtpërdrejt dispozitat e kësaj konvente në rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës.

5. Parimi i interesit më të mirë të fëmijës, i mishëruar në nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, përbën një udhërrëfyes universal dhe thelbësor në çdo veprim të ndërmarrë nga institucionet publike apo ato private që merren me fëmijë. Konventa njeh dhe garanton një sërë të drejtash themelore për fëmijët, duke filluar me të drejtën për jetë dhe zhvillim të plotë (neni 6), të drejtën për të shprehur lirshëm mendimin e tyre në të gjitha çështjet që i prekin dhe që ai mendim të merret parasysh në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës (neni 12), të drejtën për mbrojtje nga çdo formë dhune, keqtrajtimi ose neglizhence nga ana e prindërve apo kujdestarëve ligjorë, si dhe nga çdo person tjetër që kujdeset për ta (neni 19), të drejtën për standardin më të lartë të shëndetit të mundshëm dhe për shërbime të kujdesit shëndetësor (neni 24), të drejtën për jetesë në një ambient që mundëson zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social të fëmijës (neni 27), të drejtën për arsim cilësor dhe të arritshëm për të gjithë fëmijët (neni 28), si dhe mbrojtje nga shfrytëzimi ekonomik dhe punësimi që dëmton mirëqenien apo zhvillimin e tyre (neni 32). Këto të drejta dhe parime janë detyruese për të gjitha nivelet e qeverisjes dhe duhet të integrohen në legjislacionin dhe praktikat administrative për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive ndaj mbrojtjes së fëmijëve.

6. Në zbatim të dispozitave të lartëcekura nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, është miratuar Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datën 17 korrik 2019 dhe sipas nenit 66 ka hyrë në fuqi 1 vit pas publikimit.

7. Duke pasur në konsideratë rëndësinë që ka Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës përmes plotësimit të kuadrit ligjor dhe institucional, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës e ka vlerësuar nevojën që Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës t'i bëhet vlerësimi *Ex-Post*.

8. Qëllimi i këtij vlerësimi është që të identifikohen sfidat në zbatimin e këtij ligji, në veçanti për të parë se cilët janë hapat që duhet të ndërmerren për të siguruar zbatimin e tij. Më konkretisht, me këtë vlerësim *Ex-Post*, synohet të kuptohet nëse pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, nga e cila kanë kaluar afër 5 vite, a kanë qenë në dispozicion burimet e mjaftueshme për të mbështetur zbatimin e këtij ligji, nëse institucionet apo mekanizmat përgjegjës për zbatimin e tij kanë vepruar në pajtim me përgjegjësitë e tyre dhe nëse i njëjti është në harmoni me kornizën tjetër ligjore. Njëkohësisht qëllimi i këtij vlerësimi është

që për aq sa ka qenë i zbatuar, të bëjë vlerësimin e performancës, për të evidentuar se cilat kanë qenë efektet e krijuara nga zbatimi i këtij ligji.

9. Për këtë qëllim, Zyra e Kryeministrit ka themeluar Grupin Punues i cili ka autorizim të kryejë vlerësimin *Ex-Post* të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Ky grup punues udhëhiqet nga Zyra Ligjore në bashkëpunim me Zyren për Qeverisje të Mirë, në Zyrën e Kryeministrit, e në të cilin bëjnë pjesë edhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera kompetente në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

10. Gjatë hartimit të këtij raporti të vlerësimit *Ex-Post*, grupi punues është përcaktuar që të zhvillojë një pyetësor për komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim që të vlerësohet shkalla e zbatimit të këtij ligji në nivellokal, sfidat dhe vështirësitë konkrete. Për këtë qëllim, Grupi Punues, përmes anëtarit të këtij grupi nga MAPL, ka analizuar 26 komuna të Republikës së Kosovës. Rezultatet e analizave të këtyre pyetësorëve, prezantohen te pjesët përkatëse të këtij Raporti.

11. Në vlerësimin *Ex-Post* të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, grupi punues, është përcaktuar në **"Vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë",** dhe duke identifikuar shkallën e zbatimit të këtij ligji, të vëj në pah edhe efektet që janë arritur si rezultat i zbatimit, pra, të bëj për aq sa është e mundur edhe **"Vlerësimin e Perfomancës"** si dy nga tri llojet e vlerësimit *Ex-Post*.

12. Për sa i përket fushëveprimit të vlerësimit, i njëjti nuk mbulon ligjin në tërësi, por vetëm nenet të cilat rregullojnë: qëllimin e ligjit, përkufizimet, mekanzimat institucional për mbrojten e fëmijës, pastaj nenet që rregullojnë ndarjen e fëmijës nga familja, mbrojtjen e fëmijës pa përkujdesje prindërore, mbrojtjen e fëmijës gjatë qëndrimit në strehim familjar, shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës, monitorimin e masave mbrojtëse, të drejtën për të pasur një emër, shtetësinë, për të njohur prindërit dhe për të ruajtur identitetin, linjën telefonike, dispozitat ndëshkimore si dhe nenet e tjera që ndërlidhen me këto aspekte.

13. Nga të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e plotësuar nga komunat si dhe të dhënat e mbledhura nga anëtarët e grupit punues që përfaqësojnë institucionet relevante, është gjetur se Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është zbatuar përmes themelimit dhe funksionalizimit të mekanizmave institucional të përcaktuar me këtë ligj. Andaj, ky raport po ashtu nxjerr në pah nivelin e zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, sfidat që ka hasur, efektet e arritura si rezultat i zbatimit të këtij ligji, e që konsistojnë në arritjen e ndryshimeve në sjellje respektivisht në perfomancë, si në raport me qytetarët e po ashtu edhe me institucionet publike.

14. Në këtë kontekst, vlerësimi ka nxjerrë në pah disa boshllëqe të konsiderueshme sa i takon zbatimit praktik të ligjit. Në shumicën e komunave, mekanizmat e paraparë nga ligji si tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, evidencat për Parandalimin dhe ndalimin formave të rrezikshmne të punës së fëmijëve në Kosovë. Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës në Kosovë si dhe roli i Këshillit për të Drejtat e Fëmijës, janë zbatuar pjesërisht ose fare nuk janë funksionalizuar. Komunat raportojnë mungesë të udhëzimeve të qarta, ndarje të paqartë të kompetencave ndërmjet nivelit lokal dhe qendror, mungesë të buxhetit të dedikuar, mungesë të trajnimeve dhe stafit profesional të mjaftueshëm për implementimin efektiv të dispozitave të ligjit.

15. Po ashtu, Raporti rekomandon që te përkufizimet duhet larguar disa përkufizime të cilat ekzistojnë në ligj por nuk janë të përmendura në dispozitat materiale juridike të ligjit, e në disa raste janë në kundërshtim edhe me ligjet e tjera siç është Kodi i Drejtësisë për të Mitur, gjithashtu duhet të shtohen përkufizime të reja të cilat nuk janë në ligj, siç është rasti i nevojës për shtimin e përkufizimit të "fëmijës në situatë rruge", eliminimin e dispozitave të cilat janë të duplifikuara nga ligjet e tjera, largimi i disa shprehjeve dhe paragrafëve për sa i takon strukturës organizative të mekanizmave përkatës dhe dispozitat e tjera.

16. Gjithashtu, vërehet mungesë përputhshmërie ndërmjet Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe ligjeve të tjera sektoriale, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077 , Kodin Nr. 06/L-006 e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Kodin Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit siç është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-262.

17. Bazuar në këtë analizë, raporti rekomandon ndryshimin e dispozitave kyçe të këtij ligji si nenet: 1, 3, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 30, 33, 37, 52, 53, 57 dhe 62, me qëllim të harmonizimit me dispozitat e ligjeve të tjera si dhe duke eliminuar dispozitat e karakterit jo-normativ duke i shndërruar në dispozita imperative me qëllim të fuqizimit të mëtejmë të mekanizmave institucional kompetente për zbatimin e ligjit, eliminimin e dykuptimësive dhe shmangien e intepretimeve të ndryshme, pra e gjithë kjo me qëllim të fuqizimit të kornizës ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e fëmijës.

18. Gjithashtu, raporti rekomandon që me rastin e ndryshimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, të fshihen nenet 23, 27, 28, 29, 31, 34 dhe 36 pasi që të njejtat janë të rregulluara në Ligjin për Familjen dhe Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare në mënyrë specifike dhe janë përcaktuar në detaje të gjitha format e mbrojtjes së fëmijës.

I. HYRJE

I.1. Konteksti i vlerësimit

19. Gjatë procesit të monitorimit dhe raportimeve të kryera më parë, është vërejtur se institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, përkundër disa sukseseve të arritura në zbatimin e këtij ligji dhe efekteve të krijuara, megjithatë po përballen me disa vështirësi në aspektin ligjor, institucional dhe funksional, si dhe mungesë të kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore të nevojshme për arritjen e qëllimit përfundimtar të ligjit, gjegjësisht, për arritjen e ndikimit që pritej të kishte ky ligj në mbrojtjen më të mirë të fëmijëve.

20. Gjithashtu, të dhënat nga raportet e ndryshme dhe pyetësorët e plotësuar nga komunat e Republikës së Kosovës tregojnë se edhe përkundër mandatit të ministrive, komunave dhe institucioneve të tjera për mbrojtjen e fëmijëve, burimet njerëzore dhe financiare në të gjitha institucionet për të ofruar shërbime cilësore në mbrojtjen e fëmijëve vazhdojnë të jenë të kufizuara dhe të pamjaftueshme për të siguruar zbatim efikas dhe efektiv të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

21 .Prandaj, nisur nga aspektet e lartë cekura, Zyra e Kryeministrit është përcaktuar në kryerjen e vlerësimit *Ex-Post* të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

22. Pra, përzgjedhja e këtij ligji për t'iu bërë vlerësimi *Ex-Post* është bërë, ndër të tjera, duke marrë parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme që ka ky ligj në krijimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve. Po ashtu, arsye të tjera kanë qenë edhe sfidat që janë cekur në raportet e ndryshme ndër vite të hartuara nga institucionet e ndryshme publike, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të të cilat merren me fushën e mbrojtjes së fëmijës, sa i takon nivelit të pamjaftueshëm të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Njëkohësisht, ky raport vë në pah, për aq sa është e mundur nevojën për vlerësimin e perfomancës së këtij ligji, pra, për të konstatuar nëse, për aq sa është zbatuar ky ligj, a ka arritur të krijojë efekte dhe cilat janë ato efekte dhe rezultate

në fuqizimin e mbrojtjes së fëmijës dhe nëse këto efekte mund t'i atribuohen vetë zbatimit të ligjit apo se efektet e tilla janë arritur si rezultat i faktorëve të tjerë.

I.2. Qëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit

23. Qëllimi i këtij Raporti të Vlerësimit *Ex-Post* është të nxjerrë në pah sfidat kryesore në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe sfidat e organeve dhe institucioneve në aspektin ligjor, institucional dhe funksional, me theks të veçantë në kryerjen e analizës sa i takon zbatimit dhe harmonizimit të këtij ligji me legjislacionin tjetër në fuqi e po ashtu edhe rezultateve të arritura nga zbatimi i këtij ligji. Siç është potencuar edhe nga Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024, Korniza ligjore e Kosovës për të drejtat e fëmijës është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ndërkombëtare, por zbatimi mbetet i kufizuar. Mungon një sistem i integruar i mbrojtjes së fëmijëve dhe kapacitetet për përkujdesje alternative janë të pamjaftueshme. Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim në arsim dhe pjesëmarrje të ulët. Martesat e hershme vazhdojnë, sidomos në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ndërkohë, personat me aftësi të kufizuara hasin pengesa në qasje në shërbime bazë, dhe mungon harmonizimi i ligjeve me standardet e BE-së. Ligji për të drejtat e tyre ende nuk është miratuar dhe zbatimi i Konventës së OKB-së mbetet sfidë.[7] Gjithashtu, në këtë raport theksohet se mbi 88% të fëmijëve me aftësi të kufizuara mbeten jashtë procesit mësimor, ndërsa edhe ata fëmijë që vijojnë mësimin , u mungojnë kushtet dhe shërbimet e duhura, mungojnë institucionet e kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara.[8]

24. Ndërsa, në hulumtimin e quajtur "Studim mbi fëmijët në situatë rruge në Kosovë", të publikuar nga UNICEF në 10 Nëntor 2023 e të mbështetur nga Bashkimi Evropian, konstatohet se në tetë regjione të Kosovës janë identifikuar gjithsej 130 fëmijë në situatë rruge, kryesisht në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë. Shumica kanë qenë djem të moshës 10-14 vjeç dhe pjesa më e madhe u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Rreth gjysma ishin të shoqëruar nga prindërit, ndërsa të tjerët me vëllezër, shokë apo të vetëm. Varfëria u identifikua si shkaku kryesor për daljen dhe qëndrimin në rrugë (88-92%), ndërsa pak fëmijë

[7] *Shih* Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024, fq. 36, i qasshëm në https://enlargement.ec.europa.eu/document/doënload/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf më datën 01.04.2025
[8] Ibid, fq. 37.

përmendën problemet familjare. Studimi nuk gjeti dëshmi të qarta për trafikim, ndonëse kjo mund të lidhet me frikën për të raportuar raste të tilla.[9]

25. Gjithashtu, vlen të theksohet se edhe në Raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2024, theksohet se gjatë vitit 2024, janë shqyrtuar 76 raste lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijeve në Kosovë.[10]

26. Në këtë kontekst, ky vlerësim, synon që të identifikojë boshllëqet dhe të propozoj rekomandimet përkatëse për një rishikim dhe ristrukturim të duhur të kornizës ligjore dhe të ofrojë propozimet konkrete për secilin prej këtyre institucioneve në kuadër të procesit të reformave që priten të bëhen në të ardhmen.

27. Vlerësimi *Ex-Post* i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është konsideruar një instrument shumë i nevojshëm për të identifikuar nivelin e zbatimit, sfidat që janë hasur gjatë zbatimit si dhe masat që duhet ndërmarrë me qëllim të fuqizimit të zbatimit të këtij ligji, e me këtë, edhe sigurimit të zbatimit në praktikë të obligimit kushtetues për mbrojtjen e fëmijëve në Republikën e Kosovës. Njëkohësisht, ky vlerësim evidenton efektet që janë arritur nga zbatimi i këtij ligji dhe masat që duhet të ndërmerren për arritjen e ndikimit të ligjit, e që është sigurimi i mbrojtjes së fëmijës.

28. Prandaj, grupi punues ka vendosur që, sa i përket përcaktimit të fushëveprimit të këtij vlerësimi, ky vlerësim *Ex-Post* të fokusohet te "Vlerësimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë" dhe për aq sa është e mundur "Vlerësimi i Perfomancës". Ky lloj i vlerësimit është përdorur për të identifikuar shkallën e zbatimit të këtij ligji si dhe efektet që ka arritur zbatimi i tij. Prandaj, vlerësimi synon të konstatojë nëse ky ligj është zbatuar tërësisht, pjesërisht, nuk është zbatuar, apo është zbatuar por në mënyrë jo të duhur dhe se çfarë efektesh janë arritur nga zbatimi i tij dhe nëse këto efekte mund ti atribuohen zbatimit të ligjit, apo se ato janë arritur nga faktorët e tjerë.

29. Vlerësimi *Ex-Post* i bëhet Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës për periudhën nga hyrja në fuqi e deri më tani. Për sa i përket fushëveprimit të vlerësimit, i njëjti nuk mbulon ligjin në tërësi, por disa nga nenet e tij, të përshkruara si më poshtë në këtë raport tek pjesa II.

[9] *Shih* Studim mbi fëmijët në situatë rruge në Kosovë, i mbështetur nga UNICEF dhe Bashkimit Evopian, i qasshëm në linkun: https:/www.unicef.org/kosovoprogramme/media/4551/file/Albanian.pdf

[10] *Shih* Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2024, fq. 91, e qasshme në linkun: https://docs.google.com/vieëerng/vieëer?url=https://oik-rks.org/wwp-content/uploads/2025/03/Raporti-Vjetor-2024web_3_compressed.pdf&hl=en e qasur më 02.04.2025.

30. Palët e përfshira në mënyrë aktive në procesin e zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës janë: Zyra Ligjore në ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM (ZQM-ZKM), Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare në ZKM (ZPGZ-ZKM), Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, (MASHTI), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Policia e Kosovës, Institucioni e Avokatit të Popullit (IAP), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli i Pavarur i Mediave (KPM) organizatat e shoqërisë civile si: KOMF, TDH, UNICEF, Save the Children, Syri Vizion si dhe zyrtarë të tjerë në institucionet e nivelit qendror dhe lokal si dhe ekspertë të kësaj fushe.

II. PËRSHKRIMI I LIGJIT QË DO TË VLERËSOHET DHE METODOLOGJIA E ZBATUAR

II.1. Përshkrimi i ligjit ose aktit nënligjor që do të vlerësohet

31. Siç përcaktohet në nenin 1 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ky ligj ka për qëllim plotësimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale në fushën e mbrojtjes së fëmijës, mbrotjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës, ngritjen e nivelit të përgjegjësisë së prindërve, familjes dhe organeve shtetërore në interesin më të mirë të fëmijës, përcaktimi i parimeve bazë për mbrojtjen e fëmijës, mekanizmave efikas si dhe kompetencave të nivelit qëndror dhe lokal, garantimin e mirëqenies së fëmijës, marrjen e masave për zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës bazuar në interesin më të mirë të tij.[11]

32. Për qëllime të këtij vlerësimi *Ex-Post,* nenet: 1, 3, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 30, 33, 37, 52, 53, 57 dhe 62, janë objekt i vlerësimit me qëllim të harmonizimit me dispozitat e ligjeve të tjera si dhe duke eliminuar dispozitat e karakterit jo-normativ duke i shndërruar në dispozita imperative me qëllim të fuqizimit të mëtejmë të mekanizmave institucional kompetent për zbatimin e ligjit, eliminimin e dykuptimësive dhe shmangien e intepretimeve të ndryshme, pra e gjithë kjo me qëllim të fuqizimit të kornizës ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e fëmijës.

[11] *Shih* për më tepër nenin 1 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në linkun: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844, i qasur së fundmi më 05.04.2025.

33. Nga analiza e këtyre dispozitave ligjore, vërehet mungesa e harmonizimit ndërmjet Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Ligjit NR.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, Kodin Nr. 06/L-006 e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Kodin Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit siç është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-262.

34. Tutje, nuk ka koncept dokument të miratuar në lidhje me këtë ligj. Për rrjedhojë, ky raport i vlerësimit *Ex-Post* nuk do të ketë mundësi të analizojë ndërlidhjen në mes të analizës së politikave që do të përcaktoheshin në një koncept dokument dhe reflektimin e tyre në këtë vlerësim *Ex-Post*. Ky është në fakt dokumenti i parë zyrtar dhe konkret me të cilin nxirren në pah efektet e arritura dhe sfidat në zbatimin e këtij ligji, dhe si i tillë përbën një hap të rëndësishëm në fillimin e procesit të ndryshimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe harmonizimit edhe të ligjeve të tjera të veçanta, sa i takon mbrojtjes së fëmijës.

II.2. Zingjiri i rezultateve

35. Zinxhiri i rezultateve për vlerësimin *Ex-Post* të Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve është ndërtuar në përputhje me logjikën ndërhyrëse të parashikuar në Manualin për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike të Qeverisë së Kosovës, duke ndërlidhur burimet e vëna në dispozicion, aktivitetet e ndërmarra, produktet e arritura, rezultatet afatmesme dhe ndikimin afatgjatë të pritshëm.

36. Burimet (Inputet) përfshijnë mobilizimin e kapaciteteve institucionale dhe financiare në nivel qëndror dhe lokal, përfshirë themelimin e strukturave të përhershme dhe funksionale për mbrojtjen e fëmijëve, ndarjen e buxhetit të dedikuar për implementim, si dhe sigurimin e burimeve njerëzore të trajnuara dhe të specializuara në këtë fushë.

37. Në bazë të këtyre burimeve, ndërmerren një sërë aktivitetesh, të cilat përfshijnë: hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe udhëzuesve për zbatim; themelimin e mekanizmave institucionalë për identifikimin dhe trajtimin e rasteve; trajnimin e profesionistëve që punojnë me fëmijë (punonjës socialë, mësues, psikologë, policë); zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit për

publikun e gjerë dhe ndërtimin e procedurave ndërsektoriale për menaxhimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijës.

38. Produktet (Outputet) që rezultojnë nga këto aktivitete përfshijnë:themelimin dhe funksionalizimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës, themelimin dhe funksionalizimin e tryezave multidiciplinare në ndihmë të menaxhimit të rastit, rritjen e numrit të profesionistëve të trajnuar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, funksionalizimin e mekanizmave për raportimin e rasteve të dhunës, si dhe ngritjen e vetëdijes publike mbi të drejtat e fëmijës.

39. Në fazën pasuese, rezultatet (Outcomes) rritjen e efikasitetit të reagimit institucional ndaj rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, përmirësimin e kapaciteteve të komunave për të siguruar shërbime të integruara dhe të koordinuara, si dhe avancimin e kulturës institucionale dhe shoqërore për respektimin e të drejtave të fëmijës.

40. Në fund të këtij zinxhiri logjik, ndikimi (Impakti) synon të manifestohet përmes krijimit të një ambienti të sigurt, mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në Kosovë, në të cilin garantohen dhe respektohen të drejtat themelore të fëmijës, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, ndikimi afatgjatë përfshin edhe kontributin e ligjit në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të mbrojtjes së fëmijëve, i cili është reagues, preventiv dhe i përqendruar në mirëqenien e fëmijës.

41. Tabela: Zinxhiri i rezultateve për Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës

Faza	**Çështja për t'u vlerësuar**	**Treguesi**	**Burimi i të dhënave**	**Vlera bazë**	**Vlera aktuale**
Inputet	Burimet njerëzore dhe financiare në nivel qendror dhe lokal	Numri i zyrtarëve të emëruar; Shuma e buxhetit të ndarë	Raportime nga komunat; platforma qeveritare; KOMF-TDH	Nuk ka pasur punësime të reja në nivel qendror; shumica e komunave pa zyrtarë specifikë	Në nivel lokal: 18 komuna me zyrtarë; 9 pa; 3 pa përgjigje. Në nivel qendror: 2 pozita aktive në MD
Inputet	Numri i zyrtarëve për mbrojtjen e	Numri i komunave me zyrtarë të emëruar dhe buxhet specifik	Të dhëna administrative, raporte	Vetëm 3 komuna me buxhet specifik;	Raportime konkrete nga 3 komuna:

	fëmijëve dhe ndarja e buxhetit		nga MD, ZQM	shumica pa buxhet	12,000€, 2,000€, 200€
Veprimet	Nxjerrja e akteve nënligjore dhe udhëzuesve për zbatim	Numri i akteve nënligjore të miratuara	Gazeta Zyrtare, udhëzimet administrative	Asnjë akt i nxjerrë para vitit 2022	18 akte nënligjore të miratuara gjatë periudhës 2022–2024
Veprimet	Funksionalizimi i mekanizmave institucionalë dhe aktivitetet ndërgjegjësuese	Numri i mekanizmave të themeluar; numri i trajnimeve; numri i broshurave të shpërndara	Raportet e komunave, pjesëmarrja në trajnime, statistika nga ZQM	Nuk ka mekanizma lokalë të funksionalizuar në të gjitha komunat	34 EDF; 28 TNMR; 34 trajnime; mbi 7,000 broshura; 27 vizita komunale
Outputi	Trajnimet dhe ngritja e vetëdijes publike	Numri i profesionistëve të trajnuar; numri i komunave pjesëmarrëse në trajnime	Platforma për të drejtat e fëmijëve; të dhëna nga OJQ-të	Nuk ka trajnime të standardizuara dhe të përsëritura	162 zyrtarë të trajnuar; 18 komuna pjesëmarrëse në sesione
Rezultati (sjellja)	Rritja e efikasitetit institucional dhe kapaciteteve komunale	Numri i rasteve të raportuara; profesionalizmi institucional	Analiza kritike dhe burime dytësore	Mungesë e të dhënave sistematike; mungesë e raportimeve të unifikuara	Në pritje të përditësimi; mungesë e të dhënave zyrtare
Ndikimi	Ndërtimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimi i një ambienti të sigurt për fëmijët	Krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve	Raporte nga ZQM, MD, vlerësime institucionale	Mungon sistem i integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve	Progres i pjesshëm; propozim për 4 shtëpi për mbrojtje deri në vitin 2026
Veprimet	Themelimi dhe funksionalizimi i Komitetit Ndërministror dhe Këshillit për	Numri i takimeve të mbajtura dhe dokumenteve strategjike të hartuar	Raporte nga ZQM/ZKM; dokumente zyrtare të Komitetit	Komiteti dhe Këshilli të themeluar por jo aktivë para 2022	Takime të rregullta; agjenda ndër-institucionale, politika për mbrojtje dhe raporti shtetëror i

	të Drejtat e Fëmijës		dhe Këshillit		CRC të finalizuar
Outputi	Zhvillimi i platformës digjitale për të drejtat e fëmijës	Funksionaliteti dhe përdorimi i platformës https://tedrejtatefemijeve.rks-gov.net/	ZQM/ZKM dhe platforma qeveritare	Platforma jo ekzistuese para 2022	Platformë aktive me raportim digjital dhe vizualizim vjetor
Outputi	Themelimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës nëpër komuna	Numri i komunave me EDF; numri i planeve të veprimit të miratuara	Raporte nga MAPL dhe ZQM	Vetëm disa komuna me EDF; mungesë planeve veprimi	34 EDF të themeluara; 15 me plane veprimi; 26 komuna me punëtori dy-ditore
Outputi	Manuali për aktivitete jo-formale për të drejtat e fëmijëve	Finalizimi dhe shpërndarja e manualit	Zyra për Qeverisje të Mirë; MASHTI	Manuali në draft	Manuali përfunduar dhe proceduar për printim
Rezultati (sjellja)	Trajnimet për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale	Numri i trajnimeve dhe përfshirja e shkollave	Raportime nga shkollat dhe ZQM	Mungesë trajnimesh specifike	12 trajnime dy-ditore në 6 shkolla për menaxhim të rasteve
Rezultati (sjellja)	Programi për Vetëdijesimin e Publikut për Ligjin	Numri i fushatave dhe përfshirja e komuniteteve	Dokumente zyrtare, raporte nga ZQM, KOMF	Nuk ka pasur program të miratuar	Drafti final i programit i proceduar për komente
Ndikimi	Fushata "Dhuna nuk ka justifikim" dhe ndërgjegjësimi publik	Numri i qyteteve, takimeve dhe broshurave të shpërndara	Raportet nga ZQM, Syri i Vizionit, Save the Children	Fushata jo e organizuar më parë në mënyrë të koordinuar	Fushatë dy javore në 7 qytete; bashkëbisedime me qytetarë; shpërndarë mbi 7000 broshura
Ndikimi	Takime bashkëpunuese për koordinim ndërsektorial dhe	Numri i sesioneve dhe përfshirja e profesionistëve nga komunat	Raporte nga ZQM, KOMF, UNICEF	Koordinimi ndërsektorial i fragmentuar dhe informal	20 sesione dy-ditore; mbi 600 ofrues të shërbimeve nga 34 komuna

	zbatimin e ligjit				
Ndikimi	Konferenca ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës	Numri i pjesëmarrësve, temat dhe përmbajtja e diskutuar	ZQM/ZKM, QHPSM, SOS Fshatrat e Fëmijëve	Mungesë e forumeve ndërkombëtare për fëmijët	Konferencë dy-ditore për shëndetin, mirëqenien dhe edukimin e fëmijës
Veprimet	Hartimi dhe publikimi i doracakëve dhe udhëzuesve për të drejtat e fëmijëve	Numri i doracakëve dhe udhëzuesve të miratuar dhe të shpërndarë	MASHTI; faqja zyrtare e Ministrisë	Doracakët dhe udhëzuesit nuk ishin të standardizuar	Doracaku për të drejtat e fëmijëve; manuale për mbrojtje në internet; udhëzues për DKA dhe inspektorë
Outputi	Konferenca dhe fushata për të drejtat e fëmijëve në arsim	Numri i konferencave, fushatave dhe pjesëmarrësve	MASHTI; raportet e ngjarjeve	Nuk ishin të organizuara në mënyrë të rregullt	4 konferenca ndërkombëtare; fushata kundër dhunës në shkolla; Java kundër braktisjes
Rezultati (sjellja)	Zbatimi i politikave dhe trajnimeve për mbrojtjen e fëmijës në arsim	Numri i moduleve dhe trajnimeve të realizuara	MASHTI; dokumentacion zyrtar	Politikat dhe trajnimet jo të implementuara plotësisht	Zhvilluar 2 programe trajnimi; hartuar dhe miratuar Politika për Mbrojtje të Fëmijës; UA për edukimin
Rezultati (sjellja)	Zhvillimi i paketës SCREAM dhe përfshirja në shkolla	Numri i shkollave të përfshira dhe aktiviteteve të realizuara	MASHTI; platforma online	Pakoja nuk ishte e unifikuar dhe e shpërndarë	Pakoja e plotë e udhëzuesve e vendosur në faqe zyrtare; aktivitete kreative për ndërgjegjësim në nivel nacional
Ndikimi	Fuqizimi i bashkëpunimit mes	Numri i tryezave me Këshillin e Nxënësve dhe të Prindërve	MASHTI; raportet komunale	Koordinimi i fragmentuar	Seanca në të gjitha komunat;

	institucionet arsimore dhe komunitetit për të drejtat e fëmijëve			dhe jo i strukturuar	tryeza me Këshillin e Prindërve dhe Nxënësve në nivel nacional

Faza në zinxhirin e rezultateve	Çështje për t'u vlerësuar	Treguesi	Burimi/Metoda e mbledhjes së të dhënave	Vlera bazë	Vlera aktuale
Inputet	Burimet njerëzore dhe financiare në nivel qendror dhe lokal	Numri i zyrtarëve të emëruar; Shuma e buxhetit të ndarë	Raportime nga komunat; platforma qeveritare; KOMF-TDH	Nuk ka pasur punësime të reja në nivel qendror; shumica e komunave pa zyrtarë specifikë	Në nivel lokal: 18 komuna me zyrtarë; 9 pa; 3 pa përgjigje. Në nivel qendror: 2 pozita aktive në MD
Inputet	Numri i zyrtarëve për mbrojtjen e fëmijëve dhe ndarja e buxhetit	Numri i komunave me zyrtarë të emëruar dhe buxhet specifik	Të dhëna administrative, raporte nga MD, ZQM	Vetëm 3 komuna me buxhet specifik; shumica pa buxhet	Raportime konkrete nga 3 komuna: 12,000€, 2,000€, 200€
Veprimet	Nxjerrja e akteve nënligjore dhe udhëzuesve për zbatim	Numri i akteve nënligjore të miratuara	Gazeta Zyrtare, udhëzimet administrative	Asnjë akt i nxjerrë para vitit 2022	18 akte nënligjore të miratuara gjatë periudhës 2022–2024
Veprimet	Funksionalizimi i mekanizmave institucionalë dhe	Numri i mekanizmave të themeluar; numri i trajnimeve; numri i broshurave të shpërndara	Raportet e komunave, pjesëmarrja në trajnime, statistika nga ZQM	Nuk ka mekanizma lokalë të funksionalizuar në të	34 EDF; 28 TNMR; 34 trajnime; mbi

	aktivitetet ndërgjegjësuese			gjitha komunat	7,000 broshura; 27 vizita komunale
Outputi	Trajnimet dhe ngritja e vetëdijes publike	Numri i profesionistëve të trajnuar; numri i komunave pjesëmarrëse në trajnime	Platforma për të drejtat e fëmijëve; të dhëna nga OJQ-të	Nuk ka trajnime të standardizuara dhe të përsëritura	162 zyrtarë të trajnuar; 18 komuna pjesëmarrëse në sesione
Rezultati (sjellja)	Rritja e efikasitetit institucional dhe kapacitetev e komunale	Numri i rasteve të raportuara; profesionalizmi institucional	Analiza kritike dhe burime dytësore	Mungesë e të dhënave sistematike; mungesë e raportimev e të unifikuara	Në pritje të përditësimi; mungesë e të dhënave zyrtare
Ndikimi	Ndërtimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimi i një ambienti të sigurt për fëmijët	Krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve	Raporte nga ZQM, MD, vlerësime institucionale	Mungon sistem i integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve	Progres i pjesshëm; propozim për 4 shtëpi për mbrojtje deri në vitin 2026

II.3. Metodologjia

42. Zyra e Kryeministrit ka themeluar Grupin Punues i cili ka për qëllim që të kryejë vlerësimin *Ex-Post* të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Ky grup punues udhëhiqet nga Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë në ZKM si dhe me pjesëmarrës të institucioneve të tjera kompetente në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

43. Fondacioni Terre des hommes (TDH), ka ofruar mbështetjen e nevojshme teknike dhe profesionale, duke angazhuar ekspertë të fushës juridike **(Prof.**

Asoc. Dr. Bedri Bahtiri) me qëllim që të mbështesin punën e Grupit Punues në përgatitjen e vlerësimit *Ex-Post* të këtij ligji. Projekti ka ofruar edhe mbështetjen tjetër të nevojshme përmes organizimit dhe financimit të punëtorive të grupit punues për kryerjen e këtij procesi të vlerësimit.

44. Metodologjia në përgatitjen e Raportit të vlerësimit *Ex-Post* të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës konsiston në përdorimin e metodës cilësore dhe metodës së analizës. Të dhënat janë siguruar përmes pyetësorëve të dërguar nga grupi punues për institucionet e pushtetit lokal, pastaj mbledhjes së të dhënave nga institucionet përkatëse që kanë përfaqësuesit në kuadër të grupit punues, dhe analizës së të dhënave tjera të mbledhura nga burime të ndryshme.

45.Sa i përket burimeve parësore, janë analizuar dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të zbatueshme në bazë të nenit 22 të Kushtetutës, dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077 , Kodin Nr. 06/L-006 e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Kodin Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit siç është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-262. dhe aktet e tjera nënligjore si dhe raportet përkatëse përkitazi me Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

46. Në kuadër të burimeve sekondare, është bërë mbledhja e të dhënave përmes pyetësorëve të cilat janë dërguar te 26 komunat e Republikës së Kosovës, të dhënat e mbledhura nga institucionet kompetente për zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, e të cilët janë përfaqësuar në kuadër të grupit punues, të dhënat nga raportet ndërkombëtare duke përfshirë Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024, Raportin Vjetor për vitin 2024 të Institucionit të Avokatit të Popullit, Studimin e kryer nga KOMF për fëmijët në situatë rruge, si dhe dokumentet e tjera relevante.

47.Gjithashtu, përmes analizimit të raporteve relevante dhe studimeve empirike të kryera më herët nga institucionet përkatëse mbi gjendjen në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, procedurat dhe kapacitetet institucionale për ofrimin e kësaj mbrojtje kanë shërbyer si bazë e mirë për hartimin e këtij vlerësimi *Ex-Post*.

48. Për fund, një nga sfidat në procesin e kryerjes së këtij vlerësimi *Ex-Post* ka qenë mungesa e të dhënave të cilat do të dëshmonin se cila ka qenë gjendja në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, para miratimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, pasi që për këtë ligj nuk ka pasur koncept dokument të miratuar, me cka do të bëhej analiza krahasuese e gjendjes para dhe pas miratimit të ligjit. Vlen të theksohet se në këtë gjendje ka kontribuar edhe mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore me kohë, pasi që nxjerrja e tyre është vonuar përtej afateve të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ku disa prej tyre janë nxjerrë tek në vitin 2024. Po ashtu, sfiduese ka qenë mungesa e të dhënave sa i takon efektit të arritur nga zbatimit i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

49. Gjetjet nga takimet e mbajtura me institucionet e përkatëse nga fusha e mbrojtjes së fëmijës i janë prezantuar grupit punues nga eksperti i angazhuar dhe të njëjtat janë diskutuar si dhe janë reflektuar në këtë raport. Zyra Ligjore në ZKM si koordinuese e këtij procesi e ka shqyrtuar draftin e përgatitur dhe ka siguruar që raporti të ketë përmbajtjen sipas kërkesave të Manualit për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike. Njëkohësisht, Raporti i Vlerësimit *Ex-Post*, është shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli i Drejtorëve të Departamenteve Ligjore në mbledhjen e tij të mbajtur më datë 26.02.2026 dhe më pas është shqyrtuar dhe miratuar në Mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës me datën.28.10.2026 me Vendimin numër 06/08.

III. REZULTATET E VLERËSIMIT

Nënkapitulli I - Zbatueshmëria

Informacione të përgjithshme

50. Nga takimet e realizuara me institucionet kompetente, rezulton se sfidat në zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës kanë qenë të aspekteve të ndryshme, duke filluar nga aspekti i formulimit jo të saktë të normave ligjore, aspekti i harmonizimit të këtyre normave me normat e ligjeve të tjera, aspekti i mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, e të cilat kanë ndikuar në zbatim jo të mjaftueshëm të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

Qëllimi i Ligjit

51. Në nenin 1 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në paragrafin 1 ka 10 nënparagrafe, duke e zgjeruar së tepërmi qëllimin e këtij ligji. Qëllimi i ligjit duhet të jetë më i shkurtër dhe me fokus te mbrojtja e fëmijës dhe evitimi i përsëritjes së dispozitave të ligjeve të tjera.

Përkufizimet

52. Në nenin 3 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ky ligj ka përcaktuar 46 përkufizime, shumica e të cilave janë tërësisht të panevojshme pasi që të njëjtat janë të përcaktuara në ligjet e tjera, të tilla janë përkufizimet si për shembull: menagjer i rastit, qendra për punë sociale, organi i kujdestarisë, zyrtari i shërbimeve sociale, etj. Po ashtu, është e nevojshme që të përfshihet përkufizimi i ri për fëmijët në situatë rruge.

Themelimi i mekanizmave institucional për mbrojtjen e fëmijës

53. Në kapitullin III të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës janë përcaktuar mekanizmat institucional për të drejtat e fëmijës, duke filluar nga institucionet e pavarura kushtetuese si dhe institucionet e nivelit qëndror dhe lokal. Në nenin 9 paragrafi 1 të këtij ligji, si institucione të nivelit qëndror janë përcaktuar: Institucioni i Avokatit të Popullit, ministritë përkatëse të linjës, njësia përkatëse për qeverisje të mirë në ZKM, Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës dhe Këshilli për të Drejtat e Fëmijës. Për disa prej këtyre mekanizmave, kompetencat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara me ligjet dhe aktet përkatëse nënligjore. Ndërsa, për nevojat e këtij vlerësimi *Ex-Post,* do të analizohen Komiteti Ndër-Ministror për të Drejtat e Fëmijës dhe Këshilli për të Drejtat e Fëmijës, si mekanizma të themeluar me këtë ligj dhe që kanë për mision ekskluziv mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

54. Ndërsa, si struktura dhe mekanizma institucional në nivel lokal, neni 9 paragrafi 2 i këtij ligji ka përcaktuar: komunat, departamentin përkatës për shërbime sociale, qendrën për punë sociale, ekipin për të drejtat drejtat e fëmijës. Për nevojat e këtij vlerësimi *Ex-Post,* do të analizohen vetëm roli direkt i komunave

në mbrojtjen e fëmijës dhe krijimi i mekanizmave komunal të paraparë me Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Ndërsa, mekanizmat e tjerë komunal, përgjegjësitë i kanë të përcaktuara me ligjet e tjera.

Përcaktimi i kompetencave të vecanta për Komunat në fushën e mbrojtjes së fëmijës

55. Në pajtim me nenin 14 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, janë përcaktuar këto përgjegjësi për komunat:

-Identifikimin e nevojës për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të komunës së tyre;
-Hartimi dhe zbatimi i planit vjetor për mbrojtjen e fëmijës;
-Emërimi i një zyrtari për mbrojtjen e fëmijës;
-Konsultimi ndërinstitucional me ministritë përkatëse dhe shoqërinë civile;
-Funksionalizimi i familjeve strehuese;
-Marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunal për shërbime të përbashkëta.

56. Nga analiza krahasuese e pyetësorëve të plotësuar nga komunat e Republikës së Kosovës, rezulton si në vijim:

Mekanizmi Lokal	**Komuna që e kanë funksionalizuar**	**Komuna që nuk e kanë funksionalizuar**
Plan vjetor për mbrojtjen e fëmijës	Peja, Prizreni, Gjakova, Hani i Elezit	Skenderaj, Rahovec, Podujeva, Viti (në proces)
Zyrtar i caktuar për mbrojtjen e fëmijës	Peja, Prizreni, Vushtrria, Gjakova, Obiliqi	Viti, Rahovec, Mamusha, Skenderaj
Konsultime me ministri/OJQ	Peja, Gjakova, Gjilani, Prizreni, Ferizaj	Hani i Elezit, Mamusha, Skenderaj
3 familje strehuese për fëmijët pa përkujdesje	Prizreni (4), Gjilani (2), Obiliqi (2), Viti (1)	Shumica e komunave
Marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunal	Peja, Prizreni, Viti	Shumica e komunave

Me nenin 15 është përcaktuar se QPS duhet të caktojnë një zyrtarë për të drejtat e fëmijës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrje sipas legjislacionit në fuqi për mbroijtjn e fëmijës.

Themelimi i Komitetit Ndër-Ministror për të Drejtat e Fëmijës

57. Në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, është themeluar Komiteti Ndër-Ministror për të Drejtat e Fëmijës, të cilin e udhëheq

Kryeministri dhe përfaqësohet nga ministritë e linjës në nivel ministrash.[12] Është praktikë që ky Komitet, takimet e tij të rregullta t`i mbaj me 1 qershor ditën e të drejtave të fëmijëve, dhe me 20 nëntor ditën e aprovimit të Konventes për të drejtat e fëmijëve.

Themelimi i Këshillit për të Drejtat e Fëmijës

58. Në pajtim me nenin 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, është themeluar Këshilli për të Drejtat e Fëmijëve i cili udhëhiqet nga Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë në ZKM dhe përbëhet nga 21 anëtarë nga institicionet e ndryshme. Gjithashtu, kësaj përbërje i shtohen edhe dy këshilltar të jashtëm nga UNICEF e po ashtu në cilësi të anëtarëve vëshgues, këtyre numrave u shtohen edhe 5 anëtarë të tjerë nga Avokati i Popullit, përfaqësuesi i administratës nga Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik, përfaqësuesi i Koalicionit për Mbrojtjen e Viktimave (i cili mekanizëm nuk ekziston fare), Drejtori i TDH-së. Në total, Këshilli për të Drejtat e Fëmijës ka 28 anëtarë. Nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës e deri më tani, Këshilli për të Drejtat e Fëmijëve ka mbajtur takimet e tij të rregullta nga 4 për vit dhe sipas nevojës të vlerësuar nga anëtarët e Këshillit për zhvillim të politikave dhe programeve përkatëse janë zhvilluar takime shtesë dhe punëtori disa ditore.

Themelimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës

59. Në pajtim me nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është përcaktuar themelimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës i cili duhet të funksionojë në secilën komunë. Bazuar në analizën e pyetësorëve të plotësuar nga komunat, rezulton se zbatimi i nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili ka të bëjë me themelimin dhe funksionalizimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, është i pabarabartë dhe i fragmentuar në nivel lokal.

60. Komunat që kanë themeluar dhe funksionalizuar Ekipin për të Drejtat e Fëmijës:

- Prizreni – Ekipi është funksional dhe mban takime konsultuese për rastet;
- Drenasi/Gllogoci – Ekipi është themeluar, ka plan të miratuar nga Kuvendi Komunal dhe mban 6 takime në vit;
- Hani i Elezit – Ka themeluar dhe funksionalizuar ekipin, i cili harton plan veprimi dhe raporton në Kuvendin Komunal;

[12] Shih nenet 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

- Vitia – Ka themeluar ekipin dhe miratuar Rregulloren për Asamblenë e Fëmijëve, me funksione të përcaktuara institucionalisht

61. Komuna me përmendje të pjesshme ose të paqarta:
    - Skenderaj – Përmend ndërrim anëtarësh me vendim, por jo qartësim të plotë mbi funksionalizimin e ekipit;

62. Komunat që nuk e kanë përmendur ose nuk e kanë themeluar ekipin:

    - Shumica e komunave tjera nuk raportojnë ekzistencën ose funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, gjë që tregon një mangësi të theksuar në zbatimin e këtij neni;

Themelimi Tryezave Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit

63. Në pajtim me nenin 21 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është përcaktuar themelimi i Tryezave Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit. Neni 21 i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës parashikon themelimin e tryezave multidisiplinare në nivelin komunal për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. Ky mekanizëm ka për qëllim të mundësojë një qasje të koordinuar ndërmjet institucioneve relevante, por zbatimi i tij në praktikë ka rezultuar i vështirë dhe jo i njëtrajtshëm. Nga të dhënat e pyetësorëve të plotësuar nga komunat rezulton se:

    Vetëm 28 komuna[13] i kanë funksionalizuar Tryezat Multidisplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rasteve (TMNR) siç parashihet në nenin 21 të Ligjit. Megjithatë, në shumë raste ato ende nuk janë tërësisht të funksionalizura dhe operojmë vetëm në baza ad-hoc. TMNR-të janë të themeluara në këto komuna: Prishtinë, Dragash/Sharr, Gjilan, Kamenicë, Viti, Lipjan, Hani Elezit, Suharekë/Therandë, Shtime, Fushë Kosovë, Skenderaj, Malishevë, Gjakovë, Drenas, Obiliq/Kastriot, Prizren, Podujevë, Pejë, Klinë, Kacanik. Ferizaj, Junik, Deçan, Mamushë, Rahovec, Artanë, Mitrovicë, Istog.

64. Ka konfuzion në nivel komunal lidhur me përbërjen dhe mënyrën e drejtimit të tryezave, sidomos rreth rolit të menaxherit të rastit dhe vendosjes së përgjegjësive ndërinstitucionale.

[13] Kjo e dhënë është ofruar nga përfaqësuesi i TDH në Grupin Punues, në takimin e mbajtur me datën28.04.2025. marrë ngavendimet e Kryetarëve të Komunave për themelimin e Tryezave Multidisplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rasteve.

65. Në mungesë të udhëzimeve të detajuara, komunat e konsiderojnë të paqartë nivelin e formalitetit dhe frekuencën e mbledhjeve të tryezave, si dhe raportimin institucional që duhet të pasojë.

66. Tryezat multidisiplinare nuk janë përfshirë në planet vjetore të komunave dhe nuk janë të lidhura me buxhet të dedikuar, çka ndikon në mos funksionalizimin e qëndrueshëm të tyre.

67. Përfaqësimi i shkollave, shëndetësisë, policisë dhe sektorit joqeveritar është shpesh jo i plotë dhe jo aktiv në shumicën e komunave.

68. Sfidë në vete përbën mungesa e monitorimit dhe llogaridhënies lidhur me mbajtjen e tryezave multidisplinare dhe përfshirjen apo mospërfshirjen e gjithë akterëve të duhur në këto takime si dhe përmbushja e rolit professional të tyre në trajtimin e rasteve.

Themelimi i linjës telefonike për mbrojtjen e fëmijës

69. Neni 22 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ka përcaktuar funksionalizimin e linjës ndihmëse në kuadër të Njësisë përkatëse për Qeverisje të Mirë në ZKM.

70. Linja telefonike ende nuk është themeluar sipas obligimeve që rrjedhin nga neni 22 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, për shkak të mos ndarjes buxhetore. Megjithatë ZQM/ZKM në përputhje me mandatin e saj ka hartuar Udhërrëfyesin për operacionalizimin e linjës për ndihmë fëmijëve në Republikën e Kosovës, i cili shërben për të informuar funksionalizimin e Linjës Telefonike për Ndihmë Fëmijëve në Kosovë. Qëllimi i udhërrëfyesit është të përcaktoj dhe specifikojë veprimet që duhet ndërrmarur nga Qeveria deri në zbatim të nenit 22 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës.

71. Ndërsa, paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 22, vlerësohen të jenë deklarativ dhe nuk kanë përmbajtje normative dhe as nuk ndërlidhen me çështjen e linjës telefonike. Andaj, me rastin e ndryshimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, këta paragrafë duhet të riformulohen në tërësi ose të fshihen.

Neni 23 si dispozitë e duplifikuar

72. Neni 23 i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, përcakton rolin e personave fizikë dhe juridik në ofrimin e shërbimeve sociale duke theksuar se ata duhet të jenë të licencuar, por, kjo fushë në detaje është rregulluar me Ligjin për Shërbime Sociale dhe

Familjare dhe aktin nënligjor në zbatim të këtij të atij ligji. Andaj, ky nen në kapitullin III duhet të largohet, pasi që është një dispozitë duplifikuese ligjore.

Shtëpitë për Mbrojtjen e fëmijës

73. Neni 30 i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ka përcaktuar themelimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës, mirëpo, që në paragrafin 1 krijon konfuzion duke përcaktuar se këto shtëpi i themelon ministria në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale pranë qendrave për punë sociale (QPS). Ndërsa, në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale, shërbimet sociale janë kompetencë vetanake e Komunës. Një tjetër konfuzitet ka krijuar paragrafi 3 i nenit 30 i cili thekson se Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës ofrojnë shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës jo më gjatë se tri ditë. Ky paragraf është intepretuar në mënyra të ndryshme dhe ka krijuar sfida në funksionalizimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijëve, ku edhe sot e kësaj dite, ky nen nuk gjen zbatim.

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin

74. Në nenin 33 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është përcaktuar mënyra e veprimit me rastin e braktisjes së fëmijës nga prindërit biologjik, ku është përcaktuar se duhet të njoftohet Qendra për Punë Sociale brenda 24 orëve, ndërsa, dispozita nuk e përfshin detyrimin për raportimin e menjëhershëm, e gjithashtu nuk e përfshin as detyrimin e lajmërimit të policisë, pasi që braktisja e fëmijës është edhe vepër penale në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Edukimi dhe arsimimi

75. Në nenin 37 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është përcaktuar e drejta e fëmijëve në edukim dhe arsimim. Në bazë të vlerësimit të përfaqësueses së MASHT-it në grupin punues[14], sa i përket këtij neni është e nevojshme të mbahet fokusi vetëm në funksionin mbrojtës që e ka arsimimi e jo të trajtohet arsimi si e drejtë sepse kjo e drejtë garantohet me legjislacion bazë. Aktualisht janë të përmbledhura dhe po ngatërrohen rolet, duke shkaktuar probleme në referim dhe trajtim të rasteve (p.sh shumë nga rastet në nevojë për t`u mbrojtur po i dërgojnë direkt në ministri e jo në komunë, ku bie detyrimi dhe kompetenca për veprim. Përgjithësimi i roleve po krijon edhe mundësinë e shmangies nga përgjegjësia për instancat përgjegjëse.

[14] E dhëna është siguruar nga përfaqësuesja e MASHTI-t në grupin punues në takimin e mbajtur me datën 22.01.2025.

Mbrojtja e shëndetit të fëmijëve

76. Me nenin 42 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, është garantuar e drejta për kujdes shëndetësor falas. Ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni janë përcaktuar vizitat e rregullta të detyrueshme në shtëpi për gratë shtatëzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare. Këto vizita kryhen në vazhdimësi sipas standardeve të tyre pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës. Ky qëllim i vizitave është të mbrohet shëndeti i nënës dhe fëmiut, duke përfshirë këshillim dhe parandalim për sëmundje, shmangien e braktisjes së fëmijës, abuzim, shfrytëzimin dhe neglizhimin ose çdo lloj tjetër dhune ndaj fëmijës. Sipas të dhënave statistikore të paraqitura nga përfaqësuesja e MSH-së, [15]janë kryer këto vizita në shtëpi për nëna dhe fëmijë 0-3 vjec, në 34 Komuna të Kosovës:

Në vitin 2022 jane realizuar 37, 335 vizita në shtëpi
Në 2023 jane realizuar 42, 004 vizita në shtëpi
Në vitin 2024 jane realizuar 39, 554 vizita në shtëpi

Buxheti i ndarë për secilin vit është 2, 133, 390. 00 Euro.

Mbrojtja e fëmijëve nga pronografia

77. Me nenin 52 dhe 53 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është përcaktuar mbrojtja e fëmijëve nga pornografia dhe faqet e internetit me përmbajtje pornografike e të cilat nene vlerësohet se kanë nevojë për riformulime dhe ndërlidhjen e tyre me referenca konkrete te Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

78. Si sfidë e identifikuar nga përfaqësuesi i Policisë së Kosovës është edhe mungesa e një dispozite konkrete në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës e cila autorizon policinë që në të gjitha rastet e rrezikimit ose shkeljes së të drejtave të fëmijës, të ketë mundësi të intervenojë dhe të kërkojë ndalimin e shfaqjeve të videove, fotografive apo materialeve tjera që janë denigruese për fëmijë nga gjithë publikuesit online vendor apo ndërkombëtar.

79. Me nenin 57 paragrafi 10, të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, është përcaktuar krjimi i një fondi të vecantë, për Drejtoritë Komunale për mbrojtjen dhe ngritjen e shërbimeve emergjente dhe ka përckatuar nxjerrjen e një akti nënligjor me

[15] Përfaqësuesja e MSH-së, I ka ofruar këto të dhëna në grupin punues me datë 28.04.2025.

të cilin rregullohen standardet lidhur me këtë çështje. Neni duhet të riformulohet duke larguar shprehjen "krjimi i një fondi të veçantë" si dhe largimin e detyrueshmërisë për nxjerrjen e një akti nënligjor, meqenëse kjo fushë është e rregulluar me pjesën e legjislacionit në fuqi, për fushën e menaxhimit të financave publike dhe pushtetit lokal si dhe Ligjn Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Dispozitat ndëshkimore

80. Me nenin 62 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës janë përcaktuar dispozitat ndëshkimore në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji. Nga vlerësimi i këtyre dispozitave vërehet se ka pak dispozita të cilat përcaktojnë kundërvajtje për shkak se te dispozitat materiale juridike, nuk përcaktohet shkelja përkatëse për kryerjen e së cilës personi do të ndëshkohej në bazë të dispozitave ndëshkimore.

Mungesa e koordinimit ndër institucional

81. Për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm lidhur me fushën e mbrojtjes së fëmijëve si dhe mos nxjerrjes me kohë të akteve nënligjore, ka mungesë të rezultateve të mjaftueshme për përmirësimin e gjendjes ekzistuese.

Nënkapitulli II- Rëndësia:

82. Nga procesi i këtij vlerësimi *Ex-Post* rezulton se nenet 1, 3, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 30, 33, 37, 52, 53, 57 dhe 62 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës janë të rëndësishme për të siguruar kuadrin e nevojshëm procedural për zbatimin e këtij ligji që si qëllim themelor ka mbrojtjen e fëmijës. Mirëpo, në disa raste te dispozitat e caktuara mungon qartësia ose dispozitat janë më tepër deklarative, apo se çështjet që janë të rregulluara me dispozitat e tilla, janë të rregulluara edhe me ligjet e tjera, të cekura në këtë Raport. Përkundrazi, Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës do të duhej të ishte specifik dhe të evitonte përsëritjen e dispozitave të ligjeve në fuqi.

Nënkapitulli III- Harmonizimi:
Harmonizimi me standardet ndërkombëtare

83. Bazuar në të gjeturat e Komisionit Evropian në Raportin për Vendin për vitin 2024, korniza ligjore e Kosovës për të drejtat e fëmijës është kryesisht në përputhje me

standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Mirëpo, është e nevojshme që të rishikohet Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, me qëllim që i njejti të adresojë cështjet e pambuluara nga legjislacioni ekzistues për mbrojtjen e fëmijës, të shmang duplikimin e cështjeve që rregullohen edhe me Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, por edhe me ligjet e tjera përkatëse. Njëkohësisht, është e nevojshme të rishikohet Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës me qëllim të harmonizimit të tij me ligjet e tjera të veçanta, siç është elaboruar në këtë Raport më sipër.

Mungesa e koherencës së ligjit

84. Gjatë vlerësimit është evidentuar se Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në disa dispozita ka mungesë koherence edhe ndërmjet dispozitave të tij, siç është rasti me nenin 30 i cili i referohet shtëpive për mbrojtjen e fëmijës, si pasojë e së cilës jo koherencë, edhe sot e kësaj dite nuk janë themeluar këto shtëpi, për shkak të paqartësive ligjore të krijuara nga kolizioni i vetë paragrafëve të nenit 30. Në këtë kontekst, në njërën anë paragrafi 3 i nenit 30 thekson se shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës ofrojnë shërbime emergjente jo më gjatë së 3 ditë, ndërsa, në anën tjetër, paragrafi 4 i po të njejtit nen, thekson se shtëpitë e tilla shërbejnë edhe si qendra për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet e dhunës, duke përfshirë edhe raste e veprave penale kundër integritetit seksual, fëmijëve viktima dhe / apo dëshmitarë. Nga kjo shihet se periudha prej 3 ditëve nuk korrespondon me rastet që përmenden në dispozitën e paragrafit 4 të nenit 30, sepse periudha prej 3 ditëve në rastet e veprave penale të rënda të theksuara më sipër, është vetëm periudhë reflektimi dhe nuk mund të ndërmerret asnjë veprim për trajtimin e fëmijëve që janë viktima të këtyre veprave.

Mungesa e harmonizimit me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale

85. Për më tepër, neni 30 paragrafi 1 i referohet themelimit të shtëpive për mbrojtjen e fëmijës nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale pranë Qendrave për Punë Sociale. Kjo dispozitë, është e paqartë në vetvete, dhe bie ndesh me ligjin për vetqeverisje lokale pasi që shtrohet pyetja se këto shtëpi a themelohen nga niveli qëndror apo nga niveli lokal. Në nenin 17 pika k), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, ofrimi i këtyre shërbimeve për fëmijët është kompetencë vetanake e komunave, dhe jo e pushtetit qëndror.

Mungesa e harmonizimit me Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare

86. Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare ka hyrë në fuqi në vitin 2024 dhe i cili ka reformuar në tërësi fushën e shërbimeve sociale dhe familjare duke përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve e që disa prej dispozitave siç është rasti me nenin 23 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, janë të tejkaluara dhe të përgjithësuara, e të cilat është e vështirë të gjejnë zbatim.

Mungesa e harmonizimit me Kodin Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës

87. Neni 52 dhe 53 i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili përcakton mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia dhe faqet e internetit me përmbajtje pornografike, duhet të rishikohet që të ndërlidhet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, meqë se neni 231 dhe 232 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës përcaktojnë këto si vepra penale të veçanta.

Mungesa e harmonizimit me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

88. Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës në nenin 62 ka përcaktuar dispozitat ndëshkimore, por, ka mangësi pasi që të dispozitat përkatës materialo juridike, nuk janë përcaktuar shprehimisht se cilat shkelje përbën kundërvajtje, në mënyrë që të shqiptohen sanksionet për kundërvajtje. Ka raste edhe kur janë përcaktuar kundërvajtje për dispozita të cilat fare nuk e përcaktojnë shkeljen, e gjithashtu, ka dispozita që do të duhej të ishin sanksionuar te neni 62, por kjo nuk është bërë, siç është rasti me mos vijimin e shkollës. Andaj, me rastin e ndryshimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i njejti duhet të harmonizohet me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

Nënkapitulli IV-Efikasiteti:

89. Duke pasur parasysh fushëveprimin dhe llojin e këtij vlerësimi *Ex-Post*, grupi punues të vlerësojë nëse efikasiteti në zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, mund të evidentohet me të dhëna konkrete. Nëse jo, të mos zbatohet fare në këtë Raport.

IV. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

IV.1. Përfundimet

A. PËRFUNDIMET PËR ZBATUESHMËRINË

Nga analiza e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe legjislacionit tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës në fushën e Mbrojtjes së fëmijëve, si dhe akteve juridike ndërkombëtare, e gjithashtu bazuar edhe në të dhënat nga pyetësorët e komunave dhe institucioneve qendrore, del se zbatimi i ligjit ka qenë jo i njëtrajtshëm dhe i fragmentuar në shumicën e rasteve, andaj del se kjo fushë duhet të reformohet dhe avancohet. Siç mund të shihet nga analiza e bërë, përveç kolizioneve ligjore, ka edhe sfida në ushtrimin e kompetencave nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji. Në vijim do të paraqiten disa përfundime konkrete të përmbledhura, si vijon:

a. Nga analiza rezulton se ka komuna të cilat ende nuk kanë emëruar zyrtarë për mbrojtjen e fëmijës sipas përcaktmit ligjor në Ligjin për Mbrojtje të Fëmijës nenin 14 paragrafi 4. Vetëm 15 komuna kanë hartuar një Plan të Punës së Ekipit të kostuar për të drejtat e fëmijës. Ndërkaq, 12 komuna nuk kanë hartuar një plan të tillë, 2 janë në proces të hartimit dhe 1 komunë nuk ka ofruar përgjigje. Sa i përket miratimit të këtyre planeve nga Kuvendi Komunal, vetëm 14 komuna raportuan se kanë miratuar planin në Kuvend, ndërsa 13 komuna nuk e kanë miratuar.. Shumë komuna kanë sfida të ngjashme, përfshirë mungesën e stafit të dedikuar dhe mbështetjes buxhetore. Praktikat e mira të identifikuara në komunat Pejë, Prizren dhe Gjakovë, mund të shërbejnë si modele edhe për komunat e tjera.[16]

b. Nga të dhënat e mbledhura, vetëm një numër i kufizuar komunash (si Peja, Gjakova, Dragashi, Gjilani, Kacaniku, Istogu, Klina, Lipjani, Prizreni, Drenasi, Hani i Elezit dhe Viti) kanë themeluar dhe funksionalizuar Ekipin për të Drejtat e Fëmijës sipas nenit 20 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, ndërsa pjesa tjetër e komunave nuk ka pasur zbatim praktik ose nuk ka ofruar të dhëna. Kjo për faktin se ka munguar qartësia ligjore, struktura institucionale apo mbështetja për themelimin e këtij mekanizmi.

c. Tryezat multidisiplinare të parashikuara në nenin 21 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës nuk janë funksionalizuar në shumicën e komunave dhe mungon një sistem funksional i monitorimit dhe llogaridhënies.

d. Ka mungesë të theksuar të zbatimit të akteve nënligjore, të cilat janë nxjerrë me vonës shumë të mëdha dhe ka mos koordinim të duhur ndërinstitucional, siç parashihet në nenet 16–19 për Komitetin Ndërministror dhe Këshillin për të Drejtat e Fëmijës, të cilët nuk kanë funksionuar në kapacitet të plotë dhe kanë munguar rezultate të prekshme.

[16] Të dhëna këto të mbledhura nga Raporti I dorëzuar nga përfaqësuesja e MAPL-së në grup punues me datë 28.04.2025.

Meqënëse aktet nënligjore janë të reja, duhet kaluar kohë që të bëhet vlerësimi i zbatimit dhe efekteve të tyre.

e. Mungesa e stafit të trajnuar, buxhetit të dedikuar dhe kapaciteteve teknike për zbatim është evidente në të gjitha nivelet institucionale në nivel qendror dhe lokal.

f. Nga analiza e situatës, e deklaruar edhe përmes pytësorëve, del se ka mungesë të theksuar të njohurive se si duhet qasur fushës së mbrojtjes së fëmijëve.

B. PËRFUNDIMET PËR RËNDËSINË

Gjendja aktuale e fushës së mbrojtjes së fëmijëve rregullohet me disa ligje, por më kryesori në këtë raport është Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës i cili përmban dispozitat kyçe për mbrojtjen e fëmijëve, por mungesa e dispozitave normative të detyrueshme dhe duplifikimet me ligje të tjera e bëjnë përmbajtjen e tij më shumë deklarativ sesa zbatuese në praktikë. Janë identifikuar edhe zbraztësi juridike dhe kolizion ligjor, gjë e cila tregon se ka vend për përmirësime të mëdha. Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës vazhdon të jetë instrument i rëndësishëm për krijimin e bazës ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.

C. PËRFUNDIMET PËR HARMONIZIMIN

Bazuar në të gjeturat e ofruara më lartë, del se Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ka nevojë që të harmonizohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe ligjet tjera përfshirë Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077 , Kodin Nr. 06/L-006 e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Kodin Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit siç është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-262.

IV.2. Rekomandimet

A. REKOMANDIMET PËR ZBATUESHMËRINË:

A1. Me rastin e ndryshimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 1 duhet të rishikohet për ta bërë qëllimin e ligjit më të shkurtër dhe më konciz, e gjithashtu duhet të

fshihen edhe përkufizimet që përsëriten në ligjet specifike dhe të shtohet përkufizimi për fëmijët në situatë rruge (neni 3);

A2. Të ndahen fonde të veçantamjete të mjaftueshme buxhetore për nivelin qëndor, duke siguruar emërimin e zyrtarëve për mbrojtjen e fëmijës;

A3.Ministritë duhet të buxhtojne mjete të mjaftueshme financiare për sigurimin e njësive/zyrtarit të specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijës ashtu siç përcaktohet me nenin 15 paragrafin 1.4.

A4. Të ndahen mjete të mjaftueshme buxhetore për komunat, duke siguruar emërimin e zyrtarëve për mbrojtjen e fëmijës dhe hartimin e planeve komunale (neni 14);

A5. Të funksionalizohen ekipet për të drejtat e fëmijës në të gjitha komunat, duke siguruar planifikim dhe ndarje të duhur buxhetore (neni 20).

A6. Është e nevojshme të organizohen dhe zhvillohen trajnime të specializuara dhe të vazhdueshme për të gjitha subjektet e zbatimit të ligjit dhe për të gjithë sektorët (punonjësit e Qendrave për Punë Sociale, policinë, stafin arsimor dhe shëndetësor për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik).

A7. Të funksionalizohen Tryezat Multidisiplinare (neni 21), në të gjitha komunat si dhe:

i.Të institucionalizohen tryezat përmes planeve të veprimit komunal dhe të lidhin aktivitetet e tyre me linjat buxhetore të komunës. Gjithashtu është e domosdoshme vendosja e dispozitave përkatëse lidhur me monitorimin dhe llogaridhënien për sa i takon mbajtjes së tryezave multidisplinare dhe përfshirjen e gjithë akterëve të duhur në këto takime.

ii. Të zhvillohen trajnime ndërinstitucionale për anëtarët e tryezave në lidhje me qasjen multidisiplinare dhe mekanizmat e koordinimit në rastet e fëmijëve në rrezik;

iii. Të përfshihen indikatorë për matjen e performancës së tryezave dhe të raportohet në nivel qendror për funksionalitetin e tyre në baza vjetore.

A8. Të riformulohet neni 22 për linjën ndihmëse dhe të qartësohet funksionimi institucional dhe lidhja me ZQM, si dhe të përcaktohet nevoja për nxjerrjen e një akti nënligjor i cili

do të rregullonte funksionimin e linjës telefonike ndihmëse. Me rastin e ridizajnimit të linjës telfonike ndihëmse të merret parasysh integrimi i saj një linjë të vetme.

A9. Të qartësohet dhe të institucionalizohet roli i menaxherit të rastit si pjesë e strukturës së QPS-së dhe jo si mekanizëm jashtë strukturës zyrtare, për të shmangur paqartësitë në menaxhim;

A10. Të zhvillohen databaza digjitale për raportimin dhe evidentimin e rasteve të dhunës dhe rrezikut për fëmijët, me qasje ndërinstitucionale;

A11. Të ndërtohet rrjeti i familjeve strehuese me mbështetje financiare dhe trajnime;

A12. Të formalizohen marrëveshjet ndërkomunale, sidomos për komunat e vogla pa kapacitete të plota;

A13. Të bëhet shpërndarja e praktikave të mira dhe manualeve të standardizuara për mekanizmat lokalë të mbrojtjes së fëmijëve.

B. REKOMANDIMET PËR HARMONIZIMIN

Në procesin e ndryshimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës si *lex specialis*, nevojitet që të bëhet edhe harmonizimi i tij me ligjet tjera, e në veçanti, ndryshimet duhet të përfshijnë shumë çështje, e më kryesoret mund t'i përmbledhim me sa vijon:

B1. Të rishikohen dhe të ndryshohen nenet si në vijim: 1, 3, 14, 15, 16,17, 18, 19, 20, 21, 22, 30, 33, 37, 52, 53, 57 dhe 62, duke i kthyer dispozitat deklarative në dispozita detyruese dhe operative si dhe të harmonizohen me ligjet e tjera.

B2. Të fshihen nenet 23, 27,29, 31, 34 dhe 36 për shkak të duplifikimit me Ligjin për Familjen dhe Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare.

B3. Të rishikohet dhe të harmonizohet neni 30 i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe të përcaktohet qartë përgjegjësia për themelimin dhe financimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës. Për më tepër rekomandohet që ky nen të ndryshohet tërësisht, duke përcaktuar Shtëpi për Mbrojtjen e Fëmijëve nëpër regjionet e ndryshme të Kosovës, por, që trajtojnë jo rastet e njejta të fëmijëve, por rastet specifike për shkak se nuk ka nevojë që të ketë në secilin regjion shtëpi që ofrojnë të njëjtat shërbime sociale dhe familjare, sepse kjo ka edhe kosto buxhetore dhe janë të

panevojshme si të tilla. Andaj, rekomandohet që të themelohen shtëpi të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve me shërbime të integruara sociale dhe të specializuara si për shembull: shtëpi për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale, shtëpi për fëmijët me probleme të shëndetit mendor, shtëpi për fëmijë përdorues të substancave psiko aktive, si dhe shtëpi për fëmijët në rrezik, në situatë rruge dhe lëmoshëkërkues. Të vlerësohet edhe opsioni i dytë që të themelohet vetëm një shtëpi me qendër në Prishtinë, për trajtimin e të gjitha rasteve duke i ndarë në hapësira të ndryshme brenda kësaj shtëpije për trajtimin e vecantë për secilin kategori të fëmijëve si dhe duke ofruar të gjitha shërbimet e integruara brenda kësaj shtëpie. Njëkohësisht, duhet të përcaktohet kompetenca e qartë se kush financon themelimin e këtyre shtepive (niveli qëndror apo lokal) dhe po ashtu të bëhen ndarje buxhetore për plotësimin e standardeve strukturore dhe funksionale të këtyre shtëpive.

B4. Të riformulohet neni 33 paragrafi 6 për detyrimin për raportimin e menjëhershëm të braktisjes së fëmijës në QPS dhe në polici.

B5. Të saktësohet roli i sektorit të arsimit në ligj (neni 37), duke trajtuar vetëm aspektin e mbrojtjes së fëmijës, duke shmangur mbivendosjen dhe duplifikimin me Ligjin për Arsimin Parauniversitar. Rekomandohet që ky nen të ndryshohet ashtu që të hartohet në mënyrë të shkurtër e të qartë. Ky nen duhet ta qartësojë rolin mbrojtës të institucioneve arsimore sipas hierarkisë: ministri, komunë, institucione edukativo-arsimore dhe në relacionin ndërsektorial, ashtu që të dihet kush dhe çfarë duhet të bëjë sipas këtij ligji për mbrojtjen e fëmijëve.

B6. Të harmonizohen nenet 52 dhe 53 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës me Kodin Penal (nenet 231 dhe 232) për mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia. Gjithashtu duhet të shtohet dispozitë konkrete në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës e cila autorizon policinë që menjëherë të ketë mundësi të ndërmarrë veprime parandaluese dhe për të kërkuar nga të gjitha platformat online qoftë vendore apo ndërkombëtare që ofrojnë mundësinë e shfaqjes së videove apo fotografive me përmbajtje që cenon të drejtat e fëmijëve, që menjëherë ta kufizojnë mundësinë e shfaqjes së këtyre materialeve denigruese për fëmijët pa pasur nevojë për lejen apo vendimin e asnjë organi tjetër.

B7. Neni 57 duhet të rishikohet për tu harmonizuar me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin për financat e pushtetit lokal, si dhe të riformulohet duke larguar fondin e veçantë emergjent si dhe bazën juridike për nxjerrjen e një akti të vëçantë nënligjor i cili konsiderohet se nuk është i nevojshëm. Mjafton të mbetet detyrimi i Komunës për ndarjen e buxhetit për trajtimin e emergjencave të rasteve të fëmijës në nevojë.

B8. Nevojitet përcaktimi i saktë i shkeljes ligjore, përkatësisht kundërvajtjes në dispozitat materiale juridike të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, pastaj përcaktimi i sanksioneve për secilën kundërvajtje, duke e rishikuar nenin 62, si dhe caktimi saktë i organeve për shqiptimin e kundërvajtjeve. Krejt kjo me qëllim të harmonizimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës me Ligjin për Kundërvajtjet dhe sigurimit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, në pjesën e dispozitave ndëshkimore.

B9. Të ndërtohet sistem mbikëqyrës për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Ndërministror dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës, duke përfshirë raportime vjetore.

B10. Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, duhet të rishikohet dhe të adresohen rekomandime për zbatim dhe harmonizim të dalura nga ky Raport i Vlerësimit.

B11. Obligohet Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryministrit që të bëjë operacionalizimin e linjës telefonike për ndihmë të fëmijëve dhe koordinimin ndërinstitucional për zbatimin e Udhërrëfyesit ekzistues.

B12. Obligohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ta përfshi në Programin e ardhshëm të Projekligjeve.

SHTOJCAT TEKNIKE

Pjesë e këtij manuali janë shtojcat si në vijim:

Shtojca 1: Vendimi Nr.088 /2024 i datës 02.07.2024 për themelimin e Grupit Punues për Vlerësimit *Ex-Post* për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe Vendimi Nr.011/2025 i datës: 03.02.2025 për ndryshimin dhe ploetësimin e Vendimit Nr.088/2024 i datës 02.07.2024 për themelimin e Grupit Punues për Vlerësimit *Ex-Post* për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR
Njesia Org. Organizatës Org.Unit 02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot No. 846
Nr. Faqeve Br. stranica No. pages - 2 -
Data: Datum: Date: 02/07/2024
Prishtinë/a

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm – Generalni Sekretar – Secretary General

Datë: 02.07.2024
Ref: 088/2024

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, në mbështetje të nenit 20 paragrafi 5 nënparagrafi 5.3 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 07/145 të datës 07.06.2023 për aprovimin e Manualit për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike në Republikën e Kosovës, nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues për hartimin e Raportit të vlerësimit *Ex-Post* për Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në këtë përbërje:

   1.1. Mentor Borovci, ZL/ZKM, Kryesues;
   1.2. Habit Hajredini, ZQM/ZKM, Zv.Kryesues;
   1.3. Naser Canolli, Gazeta Zyrtare/ZKM, Anëtar;
   1.4. Feride Podvorica, DL/MPB, Antare;
   1.5. Naim Shala, DL/MPB, Anëtar;
   1.6. Alberita Hyseni, ZL/ZKM, Anëtare;
   1.7. Ervina Gashi, ZL/ZKM, Anëtare;
   1.8. Qëndresa Ibra Zariqi, ZQM/ZKM, Anëtare;
   1.9. Merita Jonuzi, MASHTI, Anëtare;
   1.10. Merita Vuthaj, MSh, Anëtare;
   1.11. Adile Shaqiri, MD, Anëtare;
   1.12. Luljeta Ibishi, MAPL, Anëtare;
   1.10. Nelgyn Kosova, PK, Anëtare.

2. Në takimet e grupit punues ftohen të marrin pjesë edhe:

   2.1. Donjeta Kelmendi, KOMF;
   2.2. Pajtim Zeqiri, TDH;
   2.3. Dren Rexha, UNICEF;
   2.4. Dritan Bernjashi, KGJK, Anëtarë.
   2.5. Baki Gimolli, Institucioni i Avokatit të Popullit.

3. Sipas nevojës dhe me qëllim të realizimit të obligimeve të parapara me këtë vendim, Kryesuesi i grupit punues mund të ftojë edhe ekspert dhe përfaqësues nga institucionet tjera.

4. Grupi punues obligohet që të hartoj edhe finalizojë Raportin për Vlerësimin *Ex-Post* për Ligji Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, konform rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Manualin për Vlerësimin *Ex-Post*.

5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arben KRASNIQI

U.d. Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi iu dërgohet:

- *Kryesuesit të Grupit Punues;*
- *Anëtarëve të Grupit Punues;*
- *Arkivit të Qeverisë.*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR
Njesia Org. / Org.Jedinica / Org.Unit: 02
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot No.: 846/2-2024
Nr. i faqeve / Br. stranica / No. pages: -1-
Data / Datum / Date: 03/02/2025
Prishtinë/a

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm – Generalni Sekretar – Secretary General

Datë: 03.02.2025
Ref: 011/2025

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, në mbështetje të nenit 20 paragrafi 5 nën paragrafi 5.3 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 07/145 të datës 07.06.2023 për aprovimin e Manualit për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike në Republikën e Kosovës, nxjerr:

V E N D I M
Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së Nr. 846, të datës 02.07.2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së, me Nr. 846, të datës 02.07.2024, pas pikës 1.10, shtohen pikat si në vijim:

1.11. Liridona Hoti	ZL/ZKM	Anëtare
1.12. Azem Reqica	MFPT	Anëtar;
1.13. Magbule Koci	MD	Anëtare;
1.14. Fitore Rexhaj	MD	Anëtare;
1.15. Fadil Abdyli	PK	Anëtar.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arben KRASNIQI
Sekretar i Përgjithshëm në ZKM

Vendimi iu dërgohet:
- *Kryesuesit të Grupit Punues;*
- *Anëtarëve të Grupit Punues;*
- *Arkivit të Qeverisë.*